


KOSOVA			
27.05.2019			
Pranuar	27.05	2019	
Mj. Org.	Numër	Shifra	Vendi
01-400-	28503		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstva Zdravstva- Ministry of Health

Marrëveshje e performancës

mes

Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës

dhe

Komunës së Drenas të Republikës së Kosovës

Palët

Në bazë të *marrëveshjes për financim* të kredisë numër 5442-XK, seksioni I, B, 2 (b), dhe Ligjit Nr. 06/L - 133 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, neni 14, pika 5 mbi "Shpenzimet e paparashikuara dhe rezervat " për ta përkrahur Projektin e Shëndetësisë në Kosovë, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministri i Shëndetësisë (MSh) Uran Ismaili dhe komuna e Drenas, e përfaqësuar nga kryetari i komunës Ramiz Lladrovci , e nënshkruajnë këtë marrëveshje të performancës.

Neni 1: Qëllimi

Kjo marrëveshje e performancës ka për qëllim që t'i përkufizojë obligimet përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të komunës Drenas gjatë periudhës së realizimit të skemës së pagesës sipas performancës për kapitacion (PPK) në kuadër të *marrëveshjes për financim*, të kredisë numër 5442-XK, e përmendur më lart.

R U

Neni 2: Obligimet e komunës

Obligimet e komunës janë:

- (i) Mbledhja dhe raportimi i të dhënave për performancën e institucioneve të Kujdesit parësor shëndetësor (KPSH) të komunës;
- (ii) Mirëmbajtja e shënimeve adekuate, sipas praktikave të mirëqena të kontabilitetit, të cilat i reflektojnë mjetet, veprimet dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me PPK -në;
- (iii) Sigurimi i qasjes së plotë për Qeverinë Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Bankën Botërore për inspektim të institucioneve të saj, operacioneve, shënimeve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me institucionet e KPSH-së, të përgatisë dhe t'i ofrojë të gjitha informatat që mund të kërkohen, e që janë kërkesa të arsyeshme që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje të performancës;
- (iv) Përdorimin e fondeve sipas qëllimit të përcaktuar në marrëveshje.

Neni 3: Obligimet e Ministrisë së Shëndetësisë

Obligimet e Ministrisë së Shëndetësisë janë:

- (i) Vlerësimi i arritjeve të komunës, në përmbushjen e indikatorëve të predefinuar deri me 31 dhjetor 2018 dhe 30 qershor 2019 si parakusht për inicimin e PPK në përputhje me definimin dhe procedurën të paraparë në Doracakun operativ të skemës së PPK-së;
- (ii) Realizimi me efikasitet dhe zell të plotë i aktiviteteve në kuadër të marrëveshjes së performancës në pajtim me standardet administrative, sociale, mjedisore të shëndetit publik dhe sipas praktikave të pranueshme për Bankën Botërore, si dhe në pajtim me këtë doracak operativ të skemës së PPK-së;
- (iii) Ushtrimi i të drejtave dhe realizimi i obligimeve në kuadër të marrëveshjes së performancës në atë mënyrë që t'i mbrojë interesat e qeverisë dhe të Bankës Botërore, dhe t'i përmbushë qëllimet e projektit të financuar nga Banka Botërore;
- (iv) Transferi i fondeve në komuna bazuar në të arriturat e indikatorëve të predefinuar dhe në përputhje me formulën e përcaktuar në Doracakun operativ të skemës së PPK-së;

Neni 4: Kohëzgjatja

- (i) Kjo marrëveshje bashkëpunimi deri më 31 dhjetor 2019.

R 11

- (ii) Kjo marrëveshje mund të ndryshohet ose plotësohet në pajtim mes dy palëve nënshkruese subjekt i aprovimit paraprak nga Banka Botërore.

Neni 5: Shtojca

Shtojcë e kësaj marrëveshje është Doracaku operativ i skemës së pagesës sipas performancës për kapitacion (PPK).

Palët nënshkruese

E nënshkruar në Prishtinë, Republika e Kosovës, më datë: 24 05 2019.

Uran ISMAILI

Ministër i Shëndetësisë



Rajmon LLADROVCI

Kryetar i komunës së Drenas